



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3381/ 6 prot.

Datë 20/01/2026

V E N D I M
Nr. 107/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20/01/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK me NIPT: J81527001Q, dhe me adresë: Rruga “Sulejman Delvina” Pallati “Fati”, Shk.1, Ap.19, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa: Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 29.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

II.2. Në datën 29.10.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 06.11.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	BOE “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”	34.998.900 leke	skualifikuar
2	BOE “Deutsche Energie SHPK & Technologie SHPK”	36.500.000 leke	skualifikuar
3	“Solar Energy Solutions” SHPK	39.365.690 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat, si më poshtë vijon:

“- Kontrata e bashkëpunimit midis palëve është hartuar dhe nënshkruar në bazë të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.1, datë 10.07.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” . Ligj dhe VKM të shfuqizuara.

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik është paraqitur shtojca 1, Formulari i ofertës dhe shtojca 2 Lista e çmimeve të preventivit këto në kundërshtim me Dokumentet standarde të tenderit të publikuara, në formatin e dokumenteve të tenderit të publikuara sipas vendimit Nr.10, datë 23.09.2024 të APP. Dokumentet standarde të tenderit të publikuara janë Shërbim, në zbatim të llojit të procedurës së prokurimit e cila është procedurë shërbimi.

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka plotësuar shtojcën 2 në kundërshtim me pikën 7 - Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit të Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i paraqitur nga OE Albavia sh.p.k anëtare e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik është paraqitur në kundërshtim me DT. Paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT punë.

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i paraqitur nga OE AlbPoëer Energy sh.p.k anëtare e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik është paraqitur në kundërshtim me DT. Paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT punë.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se më datë 12.11.2025, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6123, datë 25.11.2025 dhe me Nr.3381/2025 Prot., datë 25.11.2025 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrfaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare). Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 3381/1 Prot datë 26.11.2025, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Me shkresën nr. 5941/2 prot, datë 12.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3381/2 prot, datë 15.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej

tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “- Kontrata e bashkëpunimit midis palëve është hartuar dhe nënshkruar në bazë të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.1, datë 10.07.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” . Ligj dhe VKM të shfuqizuara.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2/A “Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm” të Seksionit I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME

2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm

a) “Operator ekonomik” është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si “Udhëzimet”).

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1 të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;

1.2 BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

III.1.2. Në pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave

të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.*

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

III.1.3. Referuar udhëzimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2/A “Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm” të Seksionit I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, si dhe për përmbushjen e kritereve kualifikuese të sipërpërmendura, shoqëria “ALBAVIA” SHPK ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”, duke dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dokumentat , si më poshtë vijon:

Marrëveshje Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “ALBAVIA” SHPK dhe “ALBPOËER ENERGY” SHPK, datë 23.10.2025 ku ndër të tjera citohet si më poshtë:

NENI 1
(Qëllimi)

Nepermjet kesaj marrveshje subjektet angazhohen ne per tu mbeshtetur ne kapacitetet perkatese me njera-tjetren. Kjo ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, sipas nenit 88 te VKM 285/2021 te ndryshuar dhe kriteret e pergjithshme te DST.

Per paraqitjen e nje oferte konkuruese ne tender dhe ne rast suksesi per kryerjen e punimeve te Objektit:

“MIRËMBAJTJA KORRIGJUESE DHE PARANDALUESE E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT PËR NJË PERIUDHË 2 VJEÇARE” me REF—62799-09-26-2025

Shoqërite “ALBAVIA” sh.p.k. & “ALBPOËER ENERGY” shpk, bien dakort qe te bashkojne forcat dhe kompetencat e tyre ne kuadrin e nje bashkepunimi te perkoheshem ne nje grup te vetem (referuar me poshte si “Grupi”).

Ky bashkepunim eshte eskuziv dhe reciprok dhe secila pale merr persiper konfidencialitetin e ketij bashkepunimi si dhe mos bashkimin me asnje pale tjeter te trete.

NENI 2

(Perfaqesimi dhe Pergjegjesite)

Shoqëria “ALBAVIA” shpk, do te veproje si perfaqesuese e grupit kundrejt Autoritetit Kontraktor, duke kryer te gjitha veprimet ne emer ilhe per llogari te Bashkimit te Shoqerive (Grupit):

*Perfaqesuesi do te perfaqesoje bashkimin e operatoeve ne lidhje me proceduren e shpallur nga Autoriteti Kontraktor **Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane** per tenderin me objekt **“MIRËMBAJTJA KORRIGJUESE DHE PARANDALUESE E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT PËR NJË PERIUDHË 2 VJEÇARE” me REF- *62799-09-26-2025** Perfaqesuesi do perfaqesoje bashkimin e operatoreve si ne dorezimin e kualifikimeve dhe te ofertes, e cila do te nenshkruhet nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi ka te drejte gjithashtu te nenshkruaje dhe te depozitoje te gjitha aktet e nevojshme si dhe te ndjeke procedurat perkatese prane te gjitha autoriteteve publike, apo perpara personave te trete fizike apo juridike, te nevojshme per realizimin e objektit te prokurimit te siperpermendur, si ne fazen para dhe gjate zhvillimit te gares, ashtu edhe ne ate pas saj. Per kryerjen e veprimeve te caktuara, Perfaqesuesi do te kete te drejten te autorizojte persona te trete.*

*Ne zbatim te te kesaj marrveshje, bashkimin e operatoreve emerone **Z. Shkelqim Rakipaj** perfaqesues ligjor i shoqerise “ ALBAVIA ” sh.p.k, person juridik shqiptar, i regjistruar ne regjistrin tregtar shqiptar me NIPT J81527001Q, te perfaqesoje kete grupim si perfaqesues i posacem duke i dhene te drejten qe te beje sigurimin e ofertes dhe kontrates ne emer te bashkimit te operatoreve, te nenshkruaje dhe te dergoje oferten ekonomike se bashku me dokumentat e tjera te Grupit, te lidhe kontraten me **Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane**, ne rast te shpalljes fitues, te marre pergjegjesine per te marre udhezime per zbatimin e kontrates me Autoritetin Kontraktor, te miratoje situacionet pjesore apo perfundimtare, te beje tentativa te ndryshme me shoqeri te tjera/pale te treta per llogari te bashkepunimit, te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme financiare me Autoritetin Kontraktor duke perfshire pagesat, apo ne pergjithesi, te marre pjese ne procedurat ligjore dhe/ose administrative perkatese lidhur me tenderin **“MIRËMBAJTJA KORRIGJUESE DHE PARANDALUESE E IMPIANTIT***

FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT PËR NJË PERIUDHË 2 VJEÇARE” me REF-62799-09-26-2025 te shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Ne permbushje te tagrave te kesaj marrveshjeve, Perfaqesuesi eshte ne menyre te vesante i autorizuar dhe i pajisur me tagra e te drejta te ndermarre pdo veprim tjeter qe nuk eshte specifikuar ketu por qe do te konsiderohet i nevojshem per te siguruar zbatimin e marreveshjes se bashkepunimit te nenshkruar ndermjet paleve.

Çdo veprim i kryer nga perfaqesuesi ne kuadrin e tagrave te dhena do te konsiderohet i drejte e i mireqene nga i Perfaqesuari. Per kryerjen e veprimeve te caktuara, Perfaqesuesi do te kete te drejten te autorizojte persona te trete.

Kjo marrveshje perfaqesimi është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi jane brenda tagrave të përcaktuara, në mbështetje të të drejtave që njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar.

Pavaresisht nga perqindjet e pjesemarrjes se shoqerive si me siper ne kete bashkim te perkohshem te dyja shoqerite pjesemarrese ne kete bashkim te perkohshem do te jene pergjegjese individualisht dhe ne menyre solidare ndaj Autoritetit Kontraktues ne lidhje me Kushtet e Percaktuara ne Kontraten e Prokurimit, konform nenit 423 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

NENI 3 **(Pjesemarrja)**

Pjesemarrja ne zbatimin e kontrates,do te jete:

Shoqëria “ALBPOËER ENERGY” sh.p.k. 16.01 % (Gjashtembedhjete pike Zero Një përqind)

Shoqëria “ALBAVIA” sh.p.k. 83.99% (Tetëdhjete e Tre pike Nëntëdhjete e Nëntë përqind)

NENI 4 **(Ndarja e Fitimit)**

Ndarja e fitimit do te jete ndermjet paleve eshte e percaktuar konforme perqindjeve;

Shoqëria “ALBPOËER ENERGY” sh.p.k. 16.01 % (Gjashtembedhjete pike Zero Një përqind)

Shoqëria “ALBAVIA” sh.p.k. 83.99% (Tetëdhjete e Tre pike Nëntëdhjete e Nëntë përqind)

NENI 5 **(Organizimi i kryerjes se punimeve)**

Shoqëria "ALBPOËER ENERGY" sh.p.k. do te kryeje punimet si me poshte

Zerat e punimeve te preventivit:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi	Cmimi Total
----	------------	--------	-------	-------------	-------------

1	Inverter Fronius, 27kĒ, 3Ph	Cope		460,000.00	
2	Inverter Fronius, 27kĒ, 3Ph	Cope	15.00	37,500.00	562,500.00
3	Module fotovoltaike, 480Ēp dhe 485Ēp, Monocristaline	Cope	120.00	14.000.00	1,680,000.00
4	Strukture metalike mbeshtetese per inverterat plus strukture metalike mbeshtetese (kanaline 50cin gjeresi dyfishe) per impiantin fotovoltaike.	ml	50.00	11,000.00	550,000.00
5	Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD	Cope	1.00	20,000.00	20,000.00
6	Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatesi x 8 percjelles per inverter x 111 invertera (100 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove DC)	ml	10,400.00	140.00	1,456,000.00
7	Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1000V AC(30 m gjatesi x 50 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove AC)	ml	740.00	1,400.00	1,036,000.00
8	Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrjeti Ethernet per te gjithë 167 inverterat)	ml	1,500.00	200.00	300,000.00
9	Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese periodike sipas specifikimeve teknike.	Muaj		250,000.00	
SHUMA PA TVSĒ					5,604,500.00
TVSH					1,120,900.00
TOTALI ME TVSH					6,725,400.00

Shoqëria "ALBAVIA" sh.p.k do te kryejë gjithë zërat e punimeve të tjera të preventivit.

...

NENI 7 **(Zgjidhja e mosmarreshjeve)**

Kontrata mes paleve do të zgjidhen me mirekuptim. Në të kundërt kompetente për zgjidhje do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

Kjo kontratë u perplua ne baze Kodit Civil, te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, Vendimit te KM Nr. 1 date 10.01.2007 " Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

III.1.4. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohë në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.1.5. Në nenin 14 "Operatorët ekonomikë" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të

kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit të nenit 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 2/A “Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm” të Seksionit I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë” të këtre dokumentave ka përcaktuar se oferta për këtë procedurë prokurimi mund të paraqitet edhe nga një grup operatorësh ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndërkohë që në pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku për

përmbushjen e këtyre kriterëve në rastin kur oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë enti prokurues ka përcaktuar që në dokumentacionin e ofertës duhet të paraqitet marrëveshja e bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomikë, ku të caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, si dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit, sipas parashikimeve të nenit 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) nga ana e operatorit ekonomik ofertues “ALBAVIA” SHPK, Komisioni konstaton se referuar Marrëveshje Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive datë 23.10.2025 shoqëria “ALBAVIA” SHPK ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK”, ku referuar nenit 1 të kësaj marrëveshje bashkimi i operatorëve ekonomike është krijuar sipas parashikimeve të nenit Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, duke përcaktuar qëllimin e krijimit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, përfaqësuesin e bashkimit, përqindjen e pjesëmarrjes dhe elementët konkretë të shërbimit objekt prokurimi që realizojë secili nga anaëtarët e bëtij bashkimi operatorësh ekonomikë, ndërkohë që po në këtë marrëveshje anëtarët e këtij bashkimi kanë cituar si në vijim: “Kjo kontrate u perpilua ne baze Kodit Civil, te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per ProkuriminPublik", te ndryshuar, Vendimit te KM Nr. 1 date 10.01.2007 “ Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.”.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, dokumentacioni i ofertës së dorëzuar nga ankimuesi dhe dokumentat e tenderit, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e sipërpërmendur nuk qëndron, pasi refruar nenit 1 të Marrëveshje së Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive “ALBAVIA” SHPK dhe “AlbPoëer Energy” SHPK, datë 23.10.2025, bashkimi i operatorëve ekonomike është krijuar sipas parashikimeve të nenit 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku referuar parashikimeve të kësaj dispozite në këtë marrëveshje anëtarët e këtij bashkimi kanë përcaktuar qëllimin e krijimit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, përfaqësuesin e bashkimit, përqindjen e pjesëmarrjes dhe elementët konkretë të shërbimit objekt prokurimi që realizojë secili nga anaëtarët e bëtij bashkimi operatorësh ekonomikë, ndërkohë që referuar citimi si në vijim; “Kjo kontrate u perpilua ne baze Kodit Civil, te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per ProkuriminPublik", te ndryshuar, Vendimit te KM Nr. 1 date 10.01.2007 “ Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.”. Komisioni gjykon se nuk përbën shkak për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, pasi në këtë marrëveshje bashkëpunimi anëtarët e këtij bashkimi operatorësh kanë shprehur vullnetin e tyre sipas përcaktimeve të nenit 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, dispozitë ligjore që është në fuqi, ndërsa referenca e dispozitave ligjore të shfuqizuara dhe konkretisht Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për ProkuriminPublik*”, të

ndryshuar e Vendimit të KM Nr. 1 date 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nuk kanë asnjë fuqi ligjore në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoër Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: *Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik është paraqitur shtojca 1, Formulari i ofertës dhe shtojca 2 Lista e çmimeve të preventivit këto në kundërshtim me Dokumentet standarde të tenderit të publikuara, në formatin e dokumenteve të tenderit të publikuara sipas vendimit Nr.10, datë 23.09.2024 të APP. Dokumentet standarde të tenderit të publikuara janë Shërbim, në zbatim të llojit të procedurës së prokurimit e cila është procedurë shërbimi.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3 “Lloji i kontratës” të Seksionit 2 “Objekti” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrasqit për një periudhë 2 vjeçare”.

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): Nr. REF-62799-09-26-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime të tjera -98390000-3.

2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Publike për Shërbime”.

III.2.2. Në pikën 3/B “3. Dokumentet përbërëse të Ofertës” dhe 4/B “4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve” të Seksionit I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

3. Dokumentet përbërëse të Ofertës

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar.

III.2.3. Në setin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar formularin e ofertës që duhet të dorëzojnë në dokumentacionin e ofertës operatorët ekonomike ofertues, si më poshtë:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b)** Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.2.4. Në setin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar formularin e listës së çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit që duhet të dorëzojnë në dokumentacionin e ofertës operatorët ekonomike ofertues, si më poshtë:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Njësi	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 5)
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Referohuni dokumentacionit të ngarkuar në SPE, të bashkangjitur në DST.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” konstatohet se janë dorëzuar përkatësisht Shtojca 1 dhe Shtojca 2, si më poshtë vijon:

Shtojcën 1:

Shtojca 1.

FORMULARI I OFERTËS

Data: 29/10/2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: **REF-62799-09-26-2025**

Për: **Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **“ALBAVIA” shpk** ; me numer NIPT-i **J81527001Q**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **“ALBPOËER ENERGY” shpk** ; me numer NIPT-i **M31620031D**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **“Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **BOE “ALBPOËER ENERGY” shpk & “ALBAVIA” shpk** dhe numrin unik të identifikimit **përkatësisht M31620031D & J81527001Q** nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”**.
- (c) Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **Kodi: 98390000-3** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e vlerësimit
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve;
 - 7. Termat e references (nëse është rasti);
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - (g) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: 34,998,900.00 (Tridhjetë e Kater Milion e Nenteqind e Nentedhjetë e Tete Mije e Nenteqind) Leke pa TVSH;
 - (h) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: 41,998,680.00 (Dyzet e Një Milion e Nenteqind e Nentedhjetë e Tete Mijë e Gjashteqind e Tetedhjetë) Leke me TVSH;

Shtojcën 2:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: 29/10/2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-62799-09-26-2025

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

“ALBAVIA” shpk ; me numer unik identifikimi NIPT-i J81527001Q

“ALBPOËER ENERGY” shpk ; me numer unik identifikimi NIPT-i M31620031D

Monedha: Leke

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë të preventivit. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrfaqit për një periudhë 2 vjeçare

PREVENTIV

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi	Vlera pa tvsh
1	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Cope	39.00	460,000.00	17,940,000.00
2	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Cope	15.00	37,500.00	562,500.00
3	Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485Ëp, Monocrystalline	Cope	360.00	14.000.00	5,040,000.00
4	Strukture metalike mbështetëse për inverterat plus strukture metalike mbështetëse (kanaline 50cin gjeresi dyfishe) për impiantin fotovoltaik.	ml	50.00	11,000.00	550,000.00

5	Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD	Cope	1.00	20,000.00	20,000.00
6	Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatesi x 8 percjelles per inverter x 111 invertera (100 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove DC)	ml	17,760.00	140.00	2,486,400.00
7	Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 OOOV AC(30 m gjatesi x 50 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove AC)	ml	1,500.00	1,400.00	2,100,000.00
8	Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrieti Ethernet per te gjithe 167 inverterat)	ml	1,500.00	200.00	300,000.00
9	Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese periodike sipas specifikimeve teknike.	Muaj	24.00	250,000.00	6,000,000.00
SHUMA PA TVSË					34,998,900.00
TVSH					6,999,780.00
TOTALI ME TVSH					41,998,680.00

Per; **BOE "ALBPOËER ENERGY" shpk & "ALBAVIA" shpk**

Nënshkrimi i ofertuesit: Shkëlqim Rakipaj

Vula:

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Leke

III.2.6. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK" mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të sipërpërmendur të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 5941/2 prot, datë 12.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3381/2 prot, datë 15.12.2025 ka arsyetuar si në vijim: "Pika 2 e ankesës:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) mori në shqyrtim ankesën e ankimesit, dokumentat e tenderit dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit Elektronik (SPE). Referuar dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga BOE "ALBAVIA" sh.p.k., 83,99 % me NIPT J81527001Q & "ALBPOËER ENERGY" sh.p.k., 16,01% me NIPT M31620031D, rezulton se ankimesit kanë paraqitur dokumentacionin me subjektin: " Shtojca 1-2-Formulari i Ofertës".

Referuar shtojcës 2 - Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit citohet se:

“Të gjitha zërat në formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmimi do të konsiderohen si zëra të pa ofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, kjo procedurë ndër të tjera ka këto të dhëna:

- Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar - Shërbime – me Mjete elektronike.*
- Shtojca 2 - (Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik) - Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.*

Në rastin konkret, BOE "ALBAVIA" sh.p.k., & "ALBPOËR ENERGY" sh.p.k., kanë paraqitur një tjetër shtojcë (shtojca 2) nga ai i publikuar nga Autoriteti Kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Referuar edhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe DT, citohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.”.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, sikurse respektimi i vendimit Nr.10, datë 23.09.2024 të Agjencisë së Prokurimit Publik për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Bazuar sa më sipër, pretendimi i ankimesit nuk qëndron.”, duke mos pranuar pretendimet e ankimesit.

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.8. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.
Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.9. Në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:
“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.10. Në nenin 74 “Dokumentet e tenderit” pika 1, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e dokumenteve të tenderit përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike. Autoriteti ose enti kontraktor publikon në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet, të cilat gjenerohen automatikisht në përputhje me llojin e procedurës së zgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, si edhe në përputhje me formën dhe standardin e Bashkimit Evropian.”.

III.2.11. Në nenin 14 “Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi, sipas nenit 41 të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

2. Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit, sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

3. Autoriteti/enti kontraktor, nëpërmjet mjeteve elektronike, duhet të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi.

Kur, për arsye objektive dhe të argumentuara, autoriteti/enti kontraktor nuk mund të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, duhet të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente tenderi do t’u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike dhe procedurën e qartë për pajisjen e operatorëve ekonomikë me këto dokumente. Afati për pritjen e ofertave në këtë rast, zgjatet sipas parashikimit në pikën 3, të nenit 74, të LPP-së.”.

III.2.12. Në nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e të tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

3. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP-ja, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këta të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me email).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësive të prokurimit me APP-në, në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve, rregullohen me udhëzim të APP-së.

4. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës dhe kriterëve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.

5. Në procedurat e prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës dhe kriterëve për kualifikim, do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

III.2.13. Në nenin 79 “Dorëzimi i ofertave” pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në rastin e procedurave të prokurimit me një fazë, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë dhe ofertën ekonomike, në të njëjtën kohë.

Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, me vulën e shoqërisë.”.

III.2.14. Me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar setin e dokumentave standarte të tenderit për shërbime për procedurën e prokurimit “E HAPUR” ku pjesë përbërëse janë formulari i ofertës ekonomike dhe formulari i listës së çmimeve, si më poshtë:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (i) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (j) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
----------	----------	----------	----------	----------	--

Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
	Çmimi total				
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.2.15. Me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar setin e dokumentave standarte të tenderit për punë për procedurën e prokurimit “E HAPUR”, ku pjesë përbërëse janë formulari i ofertës ekonomike dhe formulari i listës së çmimevesipas zërave të preventivit, si më poshtë:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (d)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (e)** Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (f)** Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë),

punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

8. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
9. Njoftimin e Kontratës;
10. Kriteret e Vlerësimit
11. Kriteret e Përzgjedhjes;
12. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
13. Preventivin e çmimeve
14. Termat e referencës (nëse është rasti)
15. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
16. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
17. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(k) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(l) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1						
2						
3						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.2.16. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.17. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor referuar përcaktimeve të nenin 74 “*Dokumentet e tenderit*” pika 1, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar dhe nenin 14 “*Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit*” pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar ka hartuar dhe publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) setin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku nga shqyrtimi i këtyre dokumentave konstatohet se lloji i procedurës së prokurimit objekt ankimi është e llojit “*Kontratë Shërbimi*” dhe referuar përcaktimeve të Vendimit nr. 10, datë 23.09.2024 Agjencia e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit objekt ankimi ka përdorur setin e miratuar të dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit të llojit shërbim të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, ku pjesë përbërëse e këtyre dokumentave janë Shtojca 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKË*” dhe Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*”.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se Shtojca 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKË*” duhet të plotësohet nga ana e operatorit ekonomik ofertues ku duhet të deklarohen të dhënat si në vijim: “*Data e ofertës ekonomike; Numri i referencës së procedurës së prokurimit; Emri i autoritetit kontraktor; Emri dhe NIPT-i i operatorit ekonomik ofertues; Çmimi total i ofertës ekonomike pa –TVSH dhe Çmimi total i ofertës ekonomike me-TVSH; Emri dhe Nënshkrimi i përfaqësuesit të operatorit ekonomik ofertues dhe Vula e operatorit ekonomik ofertues.*”, ndërkohë që konstaton se Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*” duhet të plotësohet nga ana e operatorit ekonomik ofertues ku duhet të deklarohen të dhënat si në vijim: “*Data e ofertës ekonomike; Numri i referencës së procedurës së prokurimit; Emri dhe NIPT-i i operatorit ekonomik ofertues; Monedha në të cilën është hartuar oferta ekonomike; Çmimi për njësi pa –TVSH për secilin element përbërës të ofertës ekonomike; Çmimi total pa –TVSH për secilin element përbërës të ofertës ekonomike; Çmimi total i ofertës ekonomike pa –TVSH; Çmimi total i ofertës ekonomike me-TVSH; Emri dhe Nënshkrimi i përfaqësuesit të operatorit ekonomik ofertues dhe Vula e operatorit ekonomik ofertues.*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK*”, Komisioni konstaton se nga ana e këtij ofertuesi janë dorëzuar Shtojca 1 “*FORMULARI I OFERTËS*” dhe Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT*”, shtojca të cilat nuk janë sipas formatit të Shtojca 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKË*” dhe Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*” të dokumentave të tenderit të publikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, por janë sipas formatit të Shtojca 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKË*” dhe Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*” tësetit të dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit të llojit punë civile të miratuara nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” e sipërpërmendur nuk qëndron, pasi nga shqyrtimi i Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 pjesë e dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ana e bashkimit të shoqërive ankimues rezulton se formati i këtyre dy shtojcave janë të miratuara me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 të Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe në Shtojcën 1 të plotësuar dhe të dorëzuara nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” jepen të dhënat si në vijim: “Data e ofertës ekonomike; Numri i referencës së procedurës së prokurimit; Emri i autoritetit kontrktor; Emri dhe NIPT-i i operatorit ekonomik ofertues; Çmimi total i ofertës ekonomike pa –TVSH dhe Çmimi total i ofertës ekonomike me-TVSH; Emri dhe Nënshkrimi i përfaqësuesit të operatorit ekonomik ofertues dhe Vula e operatorit ekonomik ofertues.”, ndërkohë që edhe në Shtojcën 2 të plotësuar dhe të dorëzuara nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” jepen të dhënat si në vijim: “Data e ofertës ekonomike; Numri i referencës së procedurës së prokurimit; Emri dhe NIPT-i i operatorit ekonomik ofertues; Monedha në të cilën është hartuar oferta ekonomike; Çmimi për njësi pa –TVSH për secilin element përbërës të ofertës ekonomike; Çmimi total pa –TVSH për secilin element përbërës të ofertës ekonomike; Çmimi total i ofertës ekonomike pa –TVSH; Çmimi total i ofertës ekonomike me-TVSH; Emri dhe Nënshkrimi i përfaqësuesit të operatorit ekonomik ofertues dhe Vula e operatorit ekonomik ofertues.”, sikurse janë kërkuar këto të dhëna nga ana e autoritetit kontraktor përkatësisht në Shtojcën 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKË*” dhe Shtojcën 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “*Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka plotësuar shtojcën 2 në kundërshtim me pikën 7 - Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit të Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në setin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar formularin e listës së çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit që duhet të dorëzojnë në dokumentacionin e ofertës operatorët ekonomike ofertues, si më poshtë:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Njësi	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 5)
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Referohuni dokumentacionit të ngarkuar në SPE, të bashkangjitur në DST.

III.3.2. Në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Referohuni dokumentacionit të ngarkuar në SPE, të bashkangjitur në DST.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Në vijim të Shtojcës 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentin e emërtuar “*Terma reference dhe specifikime teknike*” ka përcaktuar specifikimet teknike dhe sasinë e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

TERMA REFERENCE DHE SPECIFIKIME TEKNIKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

...

4. SPECIFIKIMET O&M

4.1. Përshkrimi i përgjithshëm

Ky kapitull përmban një specifikim teknik referencë tipik për aktivitetet e O&M, që do të sigurohen për funksionimin normal të impiantit.

Specifikimet dhe kërkesat për aktivitetet O&M minimalisht do të përmbajnë:

- Funksionimi dhe monitorimi i impiantit;
- Menaxhimi i impiantit;
- Mirëmbajtja parandaluese dhe korrigjuese

4.2. Operimi dhe monitorimi

Kontraktuesi do të sigurojë, duke përdorur Sistemin e Monitorimit, monitorimin e aseteve të Energjisë Fotovoltaike gjatë orëve të prodhimit të impiantit shtatë (7) ditë javë, treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë në vit.

Kontraktuesi do të sigurojë kontrollimin e Aseteve të Energjisë Fotovoltaike gjatë orëve të prodhimit të impiantit shtatë (7) ditë javë treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë në vit;

- (i) ose nga distanca,
- (ii) ose duke ndërmarrë veprime direkt në objekt (kur kjo nuk mund të zgjidhet në distancë) në rast të dështimeve që ndodhin në një nga pajisjet e impiantit.

Shërbimet që do të ofrohen nga Kontraktuesi në këtë drejtim përfshijnë:

- Monitorimi dhe optimizimi i performancës së impiantit;
- Monitorimi i të gjithë alarmeve;
- Ndërhyje parandaluese dhe korigjuese, etj.

4.3. Menaxhimi i vendit dhe HSE

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për:

- Menaxhimi mjedisor;
- Menaxhimi i H&S;

4.4. Mirëmbajtja parandaluese

Mirëmbajtja parandaluese është përfshirë në fushën e Kontraktuesit. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje të plotë me të gjitha pajisjet përkatëse dhe garancitë e përbërësve, duke ndjekur praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe kërkesat e HSE.

Kontraktuesi do të kryejë të gjitha operacionet e Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjithë përbërësit dhe pajisjet duke filluar që nga moduli PV, strukturat mbajtëse deri tek pika e lidhjes me N/S të OST siç kërkohet dhe specifikohen në Manualët e Operacioneve dhe Mirëmbajtjes së furnitorëve dhe prodhuesve, në mënyrë që të sigurojë funksionimin e duhur të impiantit PV.

4.5. Impianti PV dhe inverteret

Mirëmbajtja e moduleve PV dhe inverterave minimalisht do të përfshijë por pa u kufizuar si vijon:

- Shërbimi mujor:
 - Mirëmbajtja e inverterit siç kërkohet dhe specifikohet nga prodhuesi. Në rast të intervallave më të gjata të shërbimit, inspektimi vizual i inverterave, përfshirë filtrat, lidhjet elektrike etj, si dhe zëvendësimi / riparimi nëse del e nevojshme.

- Inspektimi vizual i strukturës mbështetëse mekanike, zëvendësimi riparimi i pjesëve të humbura / me defekt;
- Kontrolli i korrozionit (strukturat dhe pajisjet);
- Inspektimi vizual i të gjitha moduleve (100%) dhe lidhjeve elektrike të tyre si dhe zëvendësimi i tyre nëse del e nevojshme;
- Shërbimi vjetor:
 - Inspektim vizual 100% i të gjithë përbërësve të moduleve PV.
 - Skanime termike 100% të kutive kombinuese primare dhe dytësore, inverterave, moduleve PV dhe transformatorëve rritës;
- Pastrimi:
 - Pastrimi i moduleve PV dhe të të gjitha pajisjeve të tjera kritike dhe përbërësve të impiantit aq shpesh sa është e nevojshme për të ruajtur performancën e garantuar të impiantit. Fusha e O&M përfshin aq cikle pastrimi sa do të kërkohen për të mbajtur humbjet e ndotjes nën 1%;
 - Inspektimi dhe pastrimi i inverteve dhe pajisjeve shoqëruese, sipas planit të mirëmbajtjes së prodhuesit.
 - Inspektimi dhe pastrimi i transformatorëve dhe pajisjeve shoqëruese, përfshirë ndërprerësit, sipas planit të mirëmbajtjes.

4.6. Sistemi AC

- Inspektim / shërbim i rregullt vizual i nënstacionit dhe lidhjes me rjetin siç kërkohet nga plani i mirëmbajtjes dhe dokumentacioni i prodhuesve;
- Inspektimi vizual mujor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - Instalime Elektrike;
 - Strukturat mbajtëse;
 - Kabujt;
 - Pajisjet, etj.
- Inspektimi vjetor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - Kontrollin e releve dhe sistemit të mbrojtjes;
 - provat e lidhjes në tokë (nënstacionet dhe pajisjet);
 - Kalibrimi periodik dhe mirëmbajtja e pajisjeve mbrojtëse siç kërkohet kushtet teknike, etj.

4.7. Sistemi i Sigurisë

Inspektimi dhe pastrimi vizual i optikës së kamerave të sigurisë si dhe korrigjimi/zëvendësimi i tyre në rast se është e nevojshme.

4.8. Sistemi SCADA

Mirëmbajtja e sistemi SCADA duhet të garantojë funksionimin e sistemit në cdo kohë dhe saktësinë e të dhënave të tij.

4.9. Mirëmbajtja korigjuese

Mirëmbajtja korigjuese do të aplikohet që nga momenti i lidhjes së kontratës deri në përfundimin e saj. Gjatë gjithë kohës së kontratës do të jetë përgjegjësi e kontraktorit që të garantojë funksionimin e sigurt dhe eficient të impiantit PV. Kontraktori ka detyrimin të zgjidh çdo problematikë që mund të shfaqet në funksionimin e impiantit PV dhe përfshin, por nuk kufizohet në:

- Diagnostifikimi i defektit (zgjidhja e problemeve);
- Mirembajtje dhe përforcime të strukturës mbajtëse nëse do të gjykohet e nevojshme;
- Mirëmbajtje dhe riparime të elementëve të sistemit SCADA;
- Mirëmbajtja korigjuese e inverteleve dhe moduleve;
- Zëvendësimi / perforcimi i strukturave mbajtëse;
- Riparimi i nënstacionit dhe linjës në do të jetë e nevojshme;
- Instalimi i strukturave mbrojtëse ndaj erës në çdo berm të digës;
- Zëvendësimi i moduleve me defekt ose të dëmtuar;
- Zëvendësimi riparimi i inverteleve me defekt ose të dëmtuar;
- Zëvendësimi riparimi i kutive elektrike;
- Zëvendësimi Riparimi i kabllave DC AC me defekt;
- Zëvendësimi riparimi i çdo pajisjeje, përbërësi ose furnizimi tjetër që kërkohet për funksionimin e duhur të impiantit, që nga aksesoret e montimit deri tek pika e lidhjes me N/S te OST sh.a;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit MNZ. Në qdo kohë kontraktori duhet të sigurojë sasinë dhe cilësinë e pajisjeve të sistemit MNZ;
- Mirëmbajtja e sistemit SCADA. Korigjimi/zëvendësimi i pdo elementi përbërës të sistemit SCADA për të garantuar funksionimin e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit të sigurisë. Korigjimi zëvendësimi i pdo elementi përbërës të sistemit sigurisë për të garantuar funksionimin e tij;
- Mirembajtja e stacionit meteorologjik te impiantit;

4.9.1 Detyrat fillestare referuar vlerësimit paraprak

Referuar gjendjes aktuale te impiantit, detyra fillestare e kontraktorit do të jetë zëvendësimi dhe korigjimi mirëmbajtja e pajisjeve pjesëve që kanë nevojë. Sipas një vlerësimi paraprak në tabelën e mëposhtme gjenden rezultatet përkatëse fillestare.

Nr	Emertimi	Detyra	Njesia	Sasia
-----------	-----------------	---------------	---------------	--------------

1	Inverter Fronius, 27kĒ, 3Ph	Për tu zëvendësuar	Cope	39
2	Inverter Fronius, 27kĒ, 3Ph	Për tu zëvendësuar	Cope	15
3	Module fotovoltaike, 480Ēp dhe 485Ēp, Monocristaline	Për tu zëvendësuar	Cope	360
4	Strukture metalike mbeshtetese per inverterat plus strukture metalike mbeshtetese (kanaline 50cin gjeresi dyfishe) per impiantin fotovoltaike.	Për tu zëvendësuar	ml	50.
5	Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD	Për tu zëvendësuar	Cope	1
6	Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatesi x 8 percjelles per inverter x 111 invertera (100 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove DC)	Për tu zëvendësuar	ml	17760.
7	Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 OOOV AC(30 m gjatesi x 50 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove AC)	Për tu zëvendësuar	ml	1500
8	Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrieti Ethernet per te gjithë 167 inverterat)	Për tu zëvendësuar	ml	1500

4.10. Mirembajtja periodike

Pas përfundimit të procesit fillestar të mirëmbajtjes do të filloj mirëmbajtja periodike e cila do të zgjasi 24 muaj.

Qëllimi i mirëmbajtjes periodike, eshte parandalinii i defekteve dhe mirëmbajtja ne gjendje pune me kapacitet te plote te impiantit.

Per realizimin e qëllimit, detyrat kryesore te mirëmbajtjes periodike jane:

- Ndërhyrjet e shpejta në vend që kërkohen në përgjigje të një alarmi, ose sipas kërkesës së operatorit të rrjetit;
- Ndërhyrjet në vend nga Kontraktori në përgjigje të një, ose alarmeve të shumëfishta nga sistemi SCADA;
- Ndërhyrjet në vend me kërkesë të operatorit të rrjetit;
- Kontrollë periodike të gjendjes teknike të impiantit në vend.

- *Indetifikimi i alarmeve të gjeneruara nga sistemi i monitorimit, dhe marrja e masave për riparim, sipas rëndësisë së alarmit.*
- *Shërbime mirëmbajtëse profilaktike të paisjeve elektrike elektronike, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj.*
- *Pastrim i paneleve PV, rast pas rasti, sipas normës së papastërtisë, ose rënies së efikasitetit më shumë se 2% për shkak të papastërtisë.*
- *Mirëmbajtja e paisjeve elektrike duke përfshirë anën e tensionit të mesëm nga pika e lidhjes me rrjetin, tensionin e ulët AC, dhe pjesën e tensionit DC.*
- *Mirëmbajtja e vete sistemit SCADA Hardëare & Softëare (përfshirë edhe rinovim licensa, upgrade sipas rastit etj).*
- *Mirëmbajtje e elementeve mekanike, që përfshijnë probleme në strukturën mbajtëse, elementet fiksues etj.*
- *Mirëmbajtja e sistemit të sigurisë me kamera dhe stacioni meteorologjik.*

4.11. Pajisjet/elementët që do të zëvendësohen

Cdo pajisje/element i ri që do të furnizohet për të zëvendësuar pajisje/elementët që kanë nevojë duhet të plotësojë kërkesat teknike që të instalohe në harmoni me pajisjet ekzistuese dhe të garantojë funksionimin normal të të gjithë impiantit.

Të gjitha pajisjet që do të demontohen/zëvendësohen nga impianti PV do të dorëzohen në magazinën e HEC Vau i Dejës.

4.12. Përgjashtime

Aktivitetet e mëposhtme konsiderohen mirëmbajtje të jashtëzakonshme dhe janë jashtë fushës së Kontraktuesit:

- *Dëmtimet si pasojë e ngjajëve të Forcës Madhore;*
- *Dëmet e shkaktuara nga një vjedhje ose një zjarr i egër. Këtu përjashtohen rastet e zjarrit që mund të shkaktohen nga keqfunksionimi i pajisjeve përbërëse të impiantit.*

5. AFATET DHE DOKUMENTACIONI

Pas lidhjes së kontratës kontraktori brenda 14 ditë pune duhet të realizojë inspektimet dhe testet e nevojshme dhe të paraqesë në KESH sh.a rezultatet e këtij procesi si dhe specifikimet teknike të pajisjeve dhe materialeve që do të përdori. KESH sh.a brenda 5 ditëve pune do të shqyrtoj dhe do të miratohet/komentohet propozimin e kontraktorit. Pas miratimit, kontraktori do të fillojë mirëmbajtjen korrigjuese fillestare e cila duhet të përfundojë brenda 45 ditë pune nga momenti i

miratimit të raportit të inspektimit. Në përfundim të këtij procesi do të realizohet verifikimi nga AK dhe do të përpilohet akti i pranimit të shërbimit nga përfaqësuesit të AK brënda 10 ditë pune.

Pas përfundimit të kësaj faze do të filloj procesi i mirëmbajtjes korigjuese dhe parandaluese rutinë e cila do ta zgjasi 24 muaj nga data e Akt Pranimit të pranimit të shërbimit të mirëmbajtjes korigjuese fillestare. Cdo tre muaj kontraktori do të dorëzoj në KESH sh.a raportin e mirëmbajtjes periodike duke evidentuar qartë shërbimet/proceset e mirëmbajtjes që ka realizuar.

6. MBËSHTETJE QË DO TË OFROJË KESH sh.a

Për inspektimet dhe proceset e përshkruara në aktivitetet e parashikuara, KESH sh.a do të sigurojë të gjitha kalimet, lejet, etj. Gjithashtu KESH sh.a do të vendosë në dispozicion të kontraktorit gjithë dokumentacionin teknik që disponon për projektin.

7. TABELA PËRMBLEDHËSE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlera
1	Mirëmbajtja korigjuese fillestare sipas specifikimeve teknike	Komplet	1	
2	Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese periodike sipas specifikimeve teknike	Muaj	24	

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoër Energy SHPK” konstatohet se janë dorëzuar përkatësisht Shtojca 1 dhe Shtojca 2, si më poshtë vijon:

Shtojcën 1:

Shtojca 1.

FORMULARI I OFERTËS

Data: 29/10/2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-62799-09-26-2025

Për: Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i “ALBAVIA” shpk ; me numer NIPT-i J81527001Q

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i “ALBPOËER ENERGY” shpk ; me numer NIPT-i M31620031D

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (d) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: “Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrasit për një periudhë 2 vjeçare”, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

- (e) Ne **BOE “ALBPOËER ENERGY” shpk & “ALBAVIA” shpk** dhe numrin unik të identifikimit **përkatësisht M31620031D & J81527001Q** nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”**.
- (f) Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **Kodi: 98390000-3** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
11. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 12. Njoftimin e Kontratës;
 13. Kriteret e vlerësimit
 14. Kriteret e Përzgjedhjes;
 15. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 16. Preventivin e çmimeve;
 17. Termt e references (nëse është rasti);
 18. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 19. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 20. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (m) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: 34,998,900.00 (Tridhjetë e Kater Milion e Nenteqind e Nentedhjetë e Tete Mije e Nenteqind) Leke pa TVSH;
- (n) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: 41,998,680.00 (Dyzet e Një Milion e Nenteqind e Nentedhjetë e Tete Mijë e Gjashteqind e Tetedhjetë) Leke me TVSH;

Shtojcën 2:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: 29/10/2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-62799-09-26-2025

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

“ALBAVIA” shpk ; me numer unik identifikimi NIPT-i J81527001Q

“ALBPOËER ENERGY” shpk ; me numer unik identifikimi NIPT-i M31620031D

Monedha: Leke

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zëeve të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë të preventivit. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Mirëmbajtja korriqjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrfaqit për një periudhë 2 vjeçare

PREVENTIV

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi	Vlera pa tvsh
1	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Cope	39.00	460,000.00	17,940,000.00
2	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Cope	15.00	37,500.00	562,500.00
3	Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485Ëp, Monocrystalline	Cope	360.00	14.000.00	5,040,000.00
4	Strukture metalike mbështetëse për inverterat plus strukture metalike mbështetëse (kanaline 50cin gjeresi dyfishe) për impiantin fotovoltaik.	ml	50.00	11,000.00	550,000.00
5	Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD	Cope	1.00	20,000.00	20,000.00
6	Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatesi x 8 percjelles për inverter x 111 invertera (100 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove DC)	ml	17,760.00	140.00	2,486,400.00
7	Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 000V AC(30 m gjatesi x 50 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove AC)	ml	1,500.00	1,400.00	2,100,000.00

8	Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrieti Ethernet per te gjithë 167 inverterat)	ml	1,500.00	200.00	300,000.00
9	Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese periodike sipas specifikimeve teknike.	Muaj	24.00	250,000.00	6,000,000.00
SHUMA PA TVSË					34,998,900.00
TVSH					6,999,780.00
TOTALI ME TVSH					41,998,680.00

Per; **BOE “ALBPOËER ENERGY” shpk & “ALBAVIA” shpk**

Nënshkrimi i ofertuesit: Shkëlqim Rakipaj

Vula:

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Leke

III.3.4. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të sipërpërmendur të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 5941/2 prot, datë 12.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3381/2 prot, datë 15.12.2025 ka arsyetuar si në vijim: “Pika 3 e ankesës:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) mori në shqyrtim ankesën e ankimuesit, dokumentet e tenderit dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit Elektronik (SPE).

Nga shqyrtimi i Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike, konstatohen pikat si më poshtë vijojnë :

4.9.1 Detyrat fillestare referuar vlerësimit paraprak

Referuar gjendjes aktuale të impiantit, detyra fillestare e kontraktorit do të jetë zëvendësimi dhe korigjimi mirëmbajtja e pajisjeve pjesëve që kanë nevojë. Sipas një vlerësimi paraprak në tabelën e mëposhtme gjenden rezultatet përkatëse fillestare.

Nr	Emertimi	Detyra	Njesia	Sasia
1	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Për tu zëvendësuar	Cope	39
2	Inverter Fronius, 27kË, 3Ph	Për të eliminuar erroret	Cope	15
3	Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485Ëp, Monocristaline	Për tu zëvendësuar	Cope	360

4	Strukture metalike mbeshtetese per inverterat plus strukture metalike mbeshtetese (kanaline 50cin gjeresi dyfishe) per impiantin fotovoltaik.	Për tu zëvendësuar	ml	50.
5	Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD	Për tu zëvendësuar	Cope	1
6	Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatesi x 8 percjelles per inverter x 111 invertera (100 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove DC)	Për tu zëvendësuar	ml	17760.
7	Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 OOOV AC(30 m gjatesi x 50 invertera te perfshire ne demtimin e rrjetit te linjave te kablove AC)	Për tu zëvendësuar	ml	1500
8	Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrieti Ethernet per te gjithë 167 inverterat)	Për tu zëvendësuar	ml	1500

7. TABELA PËRMBLEDHËSE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlera
1	Mirëmbajtja korigjuese fillestare sipas specifikimeve teknike	Komplet	1	
2	Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese periodike sipas specifikimeve teknike	Muaj	24	

Referuar Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike, të gjitha shërbimet dhe detyrat që kontraktori duhet të realizojë, konkludohen në pikën 7 - Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit.

Që të realizohet objekti i kësaj procedure prokurimi, duhet të realizohen të gjitha detyrat e përcaktuara në Termat e References dhe Specifikimet Teknike të cilat ndahen në 2 (dy) faza.

Faza e parë e objektit të prokurimit, që është përmbledhur në një zë: "Mirëmbajtja korigjuese fillestare sipas Termave të References dhe Specifikimeve Teknike", përfshinë të gjitha punimet, shërbimet dhe furnizimet që do të jenë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të rikthyer në punë me kapacitet të plotë impiantin fotovoltaik të Qyrfaqit.

Mirëmbajtja korigjuese fillestare që duhet të realizojë Kontraktori, duhet të përmbushë të gjitha detyrat e përcaktuara në pikën 4.9 - Mirëmbajtja korigjuese, referuar Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike, si më poshtë:

- Diagnostifikimi i defektit (zgjidhja e problemeve);
- Mirembajtje dhe përforcime të strukturës mbajtëse nëse do të gjykohet e nevojshme;

- Mirëmbajtje dhe riparime të elementëve të sistemit SCADA;
- Mirëmbajtja korrigjuese e inverteleve dhe moduleve;
- Zëvendësimi / forcimi i strukturave mbajtëse;
- Riparimi i nënstacionit dhe linjës në do të jetë e nevojshme;
- Instalimi i strukturave mbrojtëse ndaj erës në çdo berm të digës;
- Zëvendësimi i moduleve me defekt ose të dëmtuar;
- Zëvendësimi riparimi i inverteleve me defekt ose të dëmtuar;
- Zëvendësimi riparimi i kutive elektrike;
- Zëvendësimi Riparimi i kabllave DC AC me defekt;
- Zëvendësimi riparimi i çdo pajisjeje, përbërësi ose furnizimi tjetër që kërkohet për funksionimin e duhur të impiantit, që nga aksesorët e montimit deri tek pika e lidhjes me N/S të OST sh.a;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit MNZ. Në qdo kohë kontraktori duhet të sigurojë sasinë dhe cilësinë e pajisjeve të sistemit MNZ;
- Mirëmbajtja e sistemit SCADA. Korrigjimi/zëvendësimi i pdo elementi përbërës të sistemit SCADA për të garantuar funksionimin e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit të sigurisë. Korrigjimi zëvendësimi i pdo elementi përbërës të sistemit sigurisë për të garantuar funksionimin e tij;
- Mirembajtja e stacionit meteorologjik të impiantit;

Tabela në piken 4.9.1, është një vlerësim paraprak, dhe nuk kemi të bëjmë me një preventiv të detajuar zbatimi, me volume saktësisht të përcaktuara. Realizimi i fazës së parë nga kontraktori do të jetë produkt i një raporti inspektimi fillestar, që duhet të përmbushë të gjitha detyrat e përcaktuara në pikën 4.9, por jo të kufizuara sipas tabelës 4.9.1.

Sa më sipër, ajo që duhet të kuptohet, është se ofertimi sipas zërave të tabelës 4.9.1 nuk përfshinë të gjithë objektin e fazës së parë të objektit të prokurimit.

Në rastin konkret BOE "ALBAVIA" sh.p.k., & "ALBPOËR ENERGY" sh.p.k., kanë plotësuar shtojcën 2 sipas pikës 4.9.1- Detyrat fillestare referuar vlerësimit paraprak, dhe jo sipas pikës 7- Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit.

Bazuar sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”, duke mos pranuar pretendimet e ankimuesit.

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.6. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.
Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
- 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.3.7. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të 27 nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të 11 parashikuara në këtë ligj.”.

III.3.8. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;*
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë*

kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

III.3.9. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. *Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*

3. *Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.”.*

III.3.10. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”

III.3.11. Në nenin 82 pika 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: - shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; - shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.”.

III.3.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit të tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.13. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentin e emërtuar “*Terma reference dhe specifikime teknike*” ka përcaktuar specifikimet teknike dhe sasinë e shërbimit objekt prokurimi, shërbim i cili përbëhet nga 3 (tre) lloje shërbimi dhe konkretisht si në vijim: “*Shërbim ‘Mirëmbajtje parandaluese’; Shërbim ‘Mirëmbajtje korrigjuese’ dhe Shërbim ‘Mirëmbajtje periodike’.*”, ku shërbimi “*Mirëmbajtje parandaluese*” do të bëhet çdo muaj gjatë gjithë

periudhës së zbatimit të kontratës, i cili përfshin shërbimet si në vijim: “Mirëmbajtja e moduleve PV dhe inverterave; Mirëmbajtja e Sistemi AC; Mirëmbajtja e Sistemit të Sigurisë dhe Mirëmbajtjen e Sistemit SCADA.”, ndërkohë që shërbimi i “**Mirëmbajtjes korrigjuese**” do të aplikohet nga momenti i lidhjes së kontratës dhe deri në realizimin e korrigjimeve, i cili përfshin shërbimet si në vijim: “Diagnostifikimi i defektit (zgjidhja e problemeve); Mirëmbajtje dhe përforsime të strukturës mbajtëse nëse do të gjykohej e nevojshme; Mirëmbajtje dhe riparime të elementëve të sistemit SCADA; Mirëmbajtja korrigjuese e inverteve dhe moduleve; Zëvendësimi/performimi i strukturave mbajtëse; Riparimi i nënstacionit dhe linjës në do të jetë e nevojshme; Instalimi i strukturave mbajtëse ndaj erës në çdo berm të digës; Zëvendësimi i moduleve me defekt ose të dëmtuar; Zëvendësimi riparimi i inverterave me defekt ose të dëmtuar; Zëvendësimi riparimi i kutive elektrike; Zëvendësimi Riparimi i kabllave DC AC me defekt; Zëvendësimi riparimi i çdo pajisjeje, përbërësi ose furnizimi tjetër që kërkohet për funksionimin e duhur të impiantit, që nga aksesorët e montimit deri tek pika e lidhjes me N/S të OST sh.a; Mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit MNZ. Në çdo kohë kontraktori duhet të sigurojë sasinë dhe cilësinë e pajisjeve të sistemit MNZ; Mirëmbajtja e sistemit SCADA. Korrigjimi/zëvendësimi i pdo elementi përbërës të sistemit SCADA për të garantuar funksionimin e tij; Mirëmbajtja e sistemit të sigurisë. Korrigjimi zëvendësimi i çdo elementi përbërës të sistemit sigurisë për të garantuar funksionimin e tij dhe Mirëmbajtja e stacionit meteorologjik të impiantit.”, shërbime të cilat referuar gjendjes aktuale të impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit përfshin shërbimet “**Korrigjuese fillestare**” të zëvendësimit të pajisjeve si në vijim: “39 copë - Inverter Fronius, 27kV, 3Ph; 15 copë - Inverter Fronius, 27kV, 3Ph; 360 copë - Module fotovoltaike, 480V dhe 485V, Monokristaline; 50 metër linear - Struktura metalike mbështetëse për inverterat plus struktura metalike mbështetëse (kanaline 50cm gjatësi dyfishe) për impiantin fotovoltai; 1 copë - Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD; 17760 metër linear - Kabel solar DC, 1x6mm², 1000V DC (20 m gjatësi x 8 përcjelles për inverter x 111 invertera (100 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove DC); 1500 metër linear - Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm² 600/1 OOOV AC(30 m gjatësi x 50 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove AC) dhe 1500 metër linear - Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrjeti Ethernet për të gjithë 167 inverterat).”, ndërsa shërbimi i “Mirëmbajtjes periodike” do të bëhet pas përfundimit të mirëmbajtjes fillestare deri në përfundim të kontratës, i cili përfshin shërbimet si në vijim: “Ndërrhyrjet e shpejta në vend që kërkohen në përgjigje të një alarmi, ose sipas kërkesës së operatorit të rrjetit; Kontrollë periodike të gjendjes teknike të impiantit në vend; Identifikimi i alarmeve të gjeneruara nga sistemi i monitorimit, dhe marrja e masave për riparim, sipas rëndësisë së alarmit; Shërbime mirëmbajtëse profilaktike të pajisjeve elektrike elektronike, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj; Pastrim i paneleve PV, rast pas rasti, sipas normës së papastërtisë, ose rënies së efikasitetit më shumë se 2% për shkak të papastërtisë; Mirëmbajtja e pajisjeve elektrike duke përfshirë anën e tensionit të mesëm nga pika e lidhjes me rrjetin, tensionin e ulët AC, dhe pjesën e tensionit DC; Mirëmbajtja e vetë sistemit SCADA Hardëare & Softëare (përfshirë edhe rinovim licensa, upgrade sipas rastit etj); Mirëmbajtje e

elementeve mekanike, që përfshijnë probleme në strukturën mbajtëse, elementet fiksues etj dhe Mirembajtja e sistemit të sigurisë me kamera dhe stacioni meteorologjik.”.

Gjithashtu në këtë dokument autoriteti kontraktor në pikën 7 “**TABELA PËRMBLEDHËSE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT**” ka grupuar shërbimet e sipërpërmendura në dy zëra shërbimi dhe konkretisht shërbimet e “*Mirëmbajtjes korrigjuese filleclare*” në sasinë e përcaktuar ‘Komplet – 1 copë”, si dhe zërin e shërbimit “*Mirembajtje parandaluese, korrigjuese dhe periodike*” në sasinë e përcaktuar “24 muaj”.

Nga shqyrtimi i Shtojcës 2 “**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**” të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik “**ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK**”, Komisioni konstaton se nga ana e këtij ofertuesi janë ofruar shërbimet “**Korrigjuese filleclare**” të zëvendësimit të pajisjeve si në vijim: “39 copë - Inverter Fronius, 27kË, 3Ph; 15 copë - Inverter Fronius, 27kË, 3Ph; 360 copë - Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485Ëp, Monocristaline; 50 metër linear - Struktura metalike mbeshtetese për inverterat plus struktura metalike mbeshtetese (kanaline 50cin gjerësi dyfishe) për impiantin fotovoltaike; 1 copë - Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD; 17760 metër linear - Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatësi x 8 përcjelles për inverter x 111 invertera (100 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove DC); 1500 metër linear - Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 OOOV AC(30 m gjatësi x 50 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove AC) dhe 1500 metër linear - Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrjeti Ethernet për të gjithë 167 inverterat).”, si dhe shërbimet e “*Mirëmbajtje parandaluese*” shërbimet e “*Mirëmbajtjes korrigjuese*” dhe shërbimet e “*Mirëmbajtjes periodike*” për një periudhë 24 muaj, pra nga data e lidhjes së kontratës dhe deri në përfundimin e saj.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e sipërpërmendur e skualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “**ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK**” nuk qëndron, pasi në ofertën e paraqitur nga ana e tyre është sipas sasisë dhe llojit të shërbimeve objekt prokurimi të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentin e emërtuar “*Terma reference dhe specifikime teknike*”, duke përfshirë ofertën ekonomike të ofertuesit për shërbimet “**Korrigjuese filleclare**” të zëvendësimit të pajisjeve si në vijim: “39 copë - Inverter Fronius, 27kË, 3Ph; 15 copë - Inverter Fronius, 27kË, 3Ph; 360 copë - Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485Ëp, Monocristaline; 50 metër linear - Struktura metalike mbeshtetese për inverterat plus struktura metalike mbeshtetese (kanaline 50cin gjerësi dyfishe) për impiantin fotovoltaike; 1 copë - Automat 4P, 50A, NSXmHm, TMD; 17760 metër linear - Kabel solar DC, lx6mm2, 1000V DC (20 m gjatësi x 8 përcjelles për inverter x 111 invertera (100 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove DC); 1500 metër linear - Kabel fuqie AC, FG16 4GX16mm2 600/1 OOOV AC(30 m gjatësi x 50 invertera të përfshirë në demtimin e rrjetit të linjave të kablove AC) dhe 1500 metër linear - Rrjet kabli Ethernet cable, CAT7, SFTP (rrjeti Ethernet për të gjithë 167 inverterat).”, si dhe për shërbimet e “*Mirëmbajtje parandaluese*” shërbimet e “*Mirëmbajtjes korrigjuese*” dhe shërbimet e “*Mirëmbajtjes periodike*” për një periudhë 24 muaj, pra nga data e lidhjes së kontratës dhe deri në përfundimin e saj.

Përsa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tyre në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “- *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i paraqitur nga OE Albavia sh.p.k anëtare e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik është paraqitur në kundërshtim me DT. Paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT punë.*

- *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i paraqitur nga OE AlbPoëer Energy sh.p.k anëtare e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik është paraqitur në kundërshtim me DT. Paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT punë.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikën 2.3 “Lloji i kontratës” të Seksionit 2 “Objekti” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrfaqit për një periudhë 2 vjeçare”.

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): Nr. REF-62799-09-26-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime të tjera -98390000-3.

2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Publike për Shërbime”.

III.4.2. Në pikën 3/B “3. Dokumentet përbërëse të Ofertës” dhe 4/B “4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve” të Seksionit I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

3. Dokumentet përbërëse të Ofertës

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar.

III.4.3. Në pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë:

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.4.4. Në pikën “KRITERET E VEÇANANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktur kriteret e veçanta të kualifikimit, si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi., ku të përfshihet të paktën kategoria e mëposhtme:

NP 10 – A Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketënë stafin e tij minimalisht:

- 1 (një) inxhinier elektrik.*
- 1 (një) inxhinier elektronik.*
- 1 (një) inxhinier mekanik.*

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontratë pune të vlefshme;*
- Diploma;*
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025;*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht personelin teknik:

- 1(një) inxhinier elektrik të trajnuar për PV;*
- 2(dy) teknik elektrik;*
- 1(një) teknik mekanik;*
- 1(një) specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë (HSE);*

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontratë pune të vlefshme;*
- Çertifikatën profesionale përkatëse, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj;*
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025;*

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon minimalisht 1(një) specialist të çertifikuar për sistemet SCADA, i cili mund të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik ose i kontraktuar me anë të një marrëveshje:

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit

të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontratë pune të vlefshme/ kontratë marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës;
- Certifikatën profesionale përkatëse, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025 në rastin nëse specialisti do të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik;

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më posht:

ISO 9001 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”,

ISO 45001 - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”,

ISO 50001 - “Sistemi i menaxhimit të energjisë”,

ISO 14001 - “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”,

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorëve të autorizuar për mallrat të cilat do të furnizohen dhe zëvendësohen në përputhje me Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike:

Zëri nr 1 – Inverter 27Kë, 3Ph.

Zëri nr 3 – Module fotovoltaike, 480Ëp dhe 485 Ëp Monocristaline.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : telefon, e-mail, ëbëside kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rastverifikimi nga ana e tij. Nrast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

2.3.8 Operatori Ekonomik në lidhje me mallrat objekt prokurimi që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve, duhet të paraqesë deklaratë se janë të çertifikuara me çertifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

III.4.5. Në setin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuara nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve publike (SPE) pjesë përbërëse është edhe Shtojca 10 “**FORMULARI PËRMbledhës I VETËDEKLARIMIT**”, si më poshtë vijon:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMbledhës I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: <i>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)</i>	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT –i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të

ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III,

Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik ALBPOËER ENERGY shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik ALBPOËER ENERGY shpk lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik ALBPOËER ENERGY shpk nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje	Po [X] Jo []

me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <i>4 Punonjës në listëpagesën për periudhën korrik - shtator 2025.</i> <u>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve / kualifikimeve) përkatëse:</u> <u>Stafi i kualifikuar për plotësimin e kriterit 2.3.4:</u> <u>1. Z. Maltin Dogani me profesion Inxhinier Elektrik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinier Elektrik, i pajisur me Diplome me titull kualifikimi Inxhinier Elektrik të trajnuar për PVi cili do të angazhohet si staf për realizimin e punimeve objekt i kësaj kontrate.</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Makinerite e mjetet me të dhënat konkrete janë të përshkruara më poshtë në seksionin C

C : DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

NE PRONESI					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë		Të tjera
ME QIRA					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
KONTRATË FURNIZIMI					
Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit		Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)		Të tjera

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

<i>Deklarata</i> <i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</i> <i>Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.</i> <i>Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:</i> Stafi I kontraktuar me anë të një marrëveshje për plotësimin e kriterit 2.3.4. 1. Z. Maltin Dogani me profesion Inxhinier Elektrik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinier Elektrik, i pajisur me Diplome me titull kualifikimi Inxhinier Elektrik të trajnuar për PVi cili do të angazhohet si staf për realizimin e punimeve objekt i kësaj kontrate, i deklaruar në këtë procedurë prokurimi; nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. Emri, Mbiemri Firma Vula Data e dorëzimit të deklaratës
--

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Marrëveshje “Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive” datë 23.10.2025, e lidhur midis shoqërisë “ALBAVIA” SHPK dhe shoqërisë “ALBPOËER ENERGY” SHPK, të cilët sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kanë krijuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & ALBPOËER ENERGY SHPK” për të paraqitur ofertë në procedurën e prokurimit me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025 dhe me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, ku shoqëria “ALBAVIA” SHPK do të kryejë

83.99% të zërave të preventivit, duke përcaktuar zërat konkret të shërbimit që do të kryejë, ndërsa shoqëria “ALBPOËER ENRGY” SHPK do të kryejë 16.01%, të zërave të preventivit, duke përcaktuar zërat konkret të shërbimit që do të kryejë.

III.4.7. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPoëer Energy SHPK” mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të sipërpërmendur të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 5941/2 prot, datë 12.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3381/2 prot, datë 15.12.2025 ka arsyetuar si në vijim: “Pika 4 e ankesës:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) mori në shqyrtim ankesën e ankimesit, dokumentet e tenderit dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit Elektronik (SPE).

Referuar dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga BOE "ALBAVIA" sh.p.k., 83,99% me NIPT J81527001Q & "ALBPOËER ENERGY" sh.p.k., 16,01% me NIPT M31620031D, rezulton se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht kanë paraqitur dokumentacionin me subjektin "shtojca 8 Albavia dhe shtojca 8 Albpoër Energy".

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton BOE "ALBAVIA" sh.p.k., & "ALBPOËER ENERGY" sh.p.k., nuk kanë paraqitur "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit" sipas shtojcës 10, të miratuar me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 "Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit "E hapur-Shërbime".

- Në lidhje me pretendimin e ankimesit se ku bazohet AK që shtojca 8 është Formular Përmbledhës për procedurë pune, sqarojmë se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht kanë paraqitur dokumentacionin me subjektin "shtojca 8 Albavia dhe shtojca 8 Albpoër Energy".

Referuar formatit, secili ka plotësuar edhe seksionet me deklaratat si me poshtë:

“DEKLARATË - "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate".

Deklarati mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera.”:.

Deklaratat e cituara më sipër nuk janë pjesë e shtojcës 10, të objektit të prokurimit të ankimuar. Nga konstatimi i Dokumenteve Standarde të një procedure pune publike, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, pjesë integrale e tyre është edhe shtojca 8.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të pergatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, sikurse respektimi i vendimit Nr.10, datë 23.09.2024 të Agjencisë së Prokurimit Publik për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti

kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit, Termat e Referencës, Specifikimet Teknike, dhe legjislacionin në fuqi. Bazuar sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk ëëndron.”, duke mos pranuar pretendimet e ankimuesit.

III.4.8. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.4.9. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.*

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.4.10. Në nenin 74 “Dokumentet e tenderit” pika 1, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e dokumenteve të tenderit përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike. Autoriteti ose enti kontraktor publikon në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet, të cilat gjenerohen automatikisht në përputhje me llojin e procedurës së zgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, si edhe në përputhje me formën dhe standardin e Bashkimit Evropian.”.

III.4.11. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. *Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.*

8. *Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.*

III.4.12. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.4.13. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.4.14. Në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të

vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.15. Në nenin 14 “Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi, sipas nenit 41 të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

2. Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit, sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

3. Autoriteti/enti kontraktor, nëpërmjet mjeteve elektronike, duhet të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi.

Kur, për arsye objektive dhe të argumentuara, autoriteti/enti kontraktor nuk mund të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, duhet të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente tenderi do t’u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike dhe procedurën e qartë për pajisjen e operatorëve ekonomikë me këto dokumente. Afati për pritjen e ofertave në këtë rast, zgjatet sipas parashikimit në pikën 3, të nenit 74, të LPP-së.”.

III.4.16. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1, 2, 3, 6 dhe 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.4.17. Në nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e të tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i

nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

3. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP-ja, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këta të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me email).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësive të prokurimit me APP-në, në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve, rregullohen me udhëzim të APP-së.

4. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës dhe kriterëve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.

5. Në procedurat e prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës dhe kriterëve për kualifikim, do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

III.4.18. Në nenin 79 “Dorëzimi i ofertave” pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në rastin e procedurave të prokurimit me një fazë, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë dhe ofertën ekonomike, në të njëjtën kohë.

Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, me vulën e shoqërisë.”.

III.4.19. Me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar setin e dokumentave standarte të tenderit për shërbime për procedurën e prokurimit “E HAPUR”, ku pjesë përbërëse është formulari i përmbledhës i vetëdeklarimit, si më poshtë:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ----

B: DEKLARATË

